



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr

Dt: 30.04.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës , në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040 , nenit 8,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, si dhe në harmoni me rekomandimin e Komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për mbështetje financiare të Klubit të Karatesë “Jehona” nga Gjakova, me dt: 30.04.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Klubit të Karatesë “Jehona” nga Gjakova nr. 10-400-17757 e dt: 03.03.2015 për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të këtij klubi për pjesëmarrje në kampionatin e Kosovës, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 1.000€.

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1.000€ nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e Klubit të Karatesë “Jehona” nr. 1140165457000130 në TEB Bank.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Klubit të Karatesë “Jehona”, Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila